DALËSE-IZLAZNA-OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 0204-1345/1
-III
Data Datum Date 31.01.2013

# Republika e Kosovës
## Republika Kosovo-Republic of Kosovo
## Qeveria - Vlada – Government

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

Datë.18/01/2013
Nr. 0204 – 1345

PËR: Nexhmedin Arifi, Kryetar i Komunës së Vitisë
Skenderbe Hebibi , Kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë

LËNDA: KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË VENDIMIT TË KOMUNËS SË VITISË Nr.01 013/1461.

Pranuar me datë: 24.12.2012

Të nderuar/a

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, shtojcën XII të Rregullores së Qeverisë 02/2011 për Fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit Ministrive, pas shqyrtimit të Vendimit të miratuar me datë 14/12/2012, **KONFIRMON** ligjshmërinë e këttij akti dhe vlerëson se i njëjti është në në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Akti juridik i cili ka efekt të plotë juridik;

- Vendim Nr. 01 013/1461 për shfuqizimin e vendimit për bartjen e të drejtës së shfrytëzimit të paluajtshmërisë (tokë) në pronësi shoqërore pronë e Kuvendit të Komunës së Vitisë në shfrytëzuesin të përkohshëm për Fatime Ramadanin.

Me respekt,

**Slobodan Petrović,**
**Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i MAPL,**

**Kopje:** *Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL-së*
*Drejtorëve të Departamenteve dhe Zyrave*
*Arkivit të MAPL-së.*

DALËSE-IZLAZNA-OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 0204-1345/1
-III-
Data Datum Date 31.01.2013

# Republika e Kosovës
## Republika Kosovo-Republic of Kosovo
### Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

Datum 24/01/2013
Br. 0204 – 1345

Za: Nexhmedin Arifi, Gradonačelnik opštine Vitina
Skenderbe Hebibi , Predsedavajući skupštine opštine Vitina

Predmet Potvrda zakonitosti odluka opštine Vitina
Br.01 013/1461.

Primljeno dana 24.12.2012

Poštovani /e

Ministarstvo administracije lokalne samouprave u skladu sa njenim mandatom definisano zakonom o lokalnoj samoupravi br. 03/z-040, dodatak XII uredbe Vlade 02/2011 o odgovornim administrativnim oblastima kancelarije premijera i ministarstva nakon razmatranja odluka odobreno dana 14/12/2012, **POTVRĐUJE zakonitost ovih akata i procenjuje da su isti ti u potpunom skladu sa zakonom o loklanoj samoupravi** .

Pravni akti sa potpunim pravnim dejstvom su, kao što sledi ;

- Odluka br. 01 013/1461 o ukidanju odluke za prenos prava na korišćenje nepokretne imovine (zemljišta) u društvenom vlasništvu, vlasništvo Skupštine opštine Vitina privremenom korisniku Fatime Ramadani.

Sa poštovanjem ,

**Slobodan Petrović,**
**Zamenik premijera i ministar MALS-a**

**Kopija:** *Besnik Osmani, Generalni sekretar MALS-a*
*Direktorima odeljenja i kancelarija*
*Arhivi MALS-a.*

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA
13. 12. 2012
01- 013 / 1461

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 12.2 shkronja d) lidhur me nenin 82.3 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kuvendit të Republikës së Kosovës ( Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr 28/1008, Rekomandimit të MAPL-së dhe nenit 36.2. shkronja d) të Statutit të Komunës së Vitisë 01 nr 013/491 të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më 14 dhjetor 2012 aprovon këtë:

# VENDIM

## PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT PËR BARTJEN E TË DREJTËS SË SHFRYTËZIMIT TË PALUAJTSHMËRISË (TOKË) NË PRONËSI SHOQËRORE PRONË E KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË NË SHFRYTËZUESIN E PËRKOHËSHËM FATIME RAMADANI

Neni 1

Me këtë vendimi, Kuvendi i Komunës së Vitisë SHFUQIZON Vendimin për bartjen e të drejtës së shfrytëzimit të pa luajtshmërisë ( tokës) të pronësi shoqërore pronë e Kuvendit të Komunës së Vitisë në shfrytëzuesin e përkohshëm Fatime Ramadani me nr 01-013/141 të datës 09.02.2012.

**Neni 2**

Shfuqizimi i vendimit nga neni 1 i këtij vendimi bëhet në bazë të rekomandimit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal të Republikës së Kosovës, dhe rrjedh si pasoj e pengesave ligjore, sepse me rastin e dhënies në shfrytëzim të pronës komunale duhet të zbatohen kriteret e përcaktuara me Ligjin për Prokurim, neni 5 pika 2 che 3 të Ligjit nr 03/L-226, si dhe Udhëzimi Administrativ nr 2012/02 për zbatimin e Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

**Neni 3**

Ditën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, **shfuqizohen** të gjitha pasojat juridike të cilat janë prodhuar me Vendimin për bartjen e të drejtës së shfrytëzimit të pa luajtshmërisë ( tokës) në pronësi shoqërore pronë e Kuvendit të Komunës së Vitisë në shfrytëzuesin e përkohshëm Fatime Ramadani me nr 01-013/141 të datës 09.02.2012.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Kadastër Pronë dhe Gjeodezi e Komunës së Vitisë.

**Neni 5**

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

01 Nr ________
Viti, 18 dhjetor 2012

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË
KRYESUESI
Skenderbe Hebibi